



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 682, DATË
29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E
FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE
ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË
VENDBANIMIT", I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN

Projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar", mundëson përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve të sistemit arsimor parauniversitar publik që punojnë jashtë vendbanimit dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit. Ky projektvendim synon krijimin e kushteve më të mira të nxënësve dhe të punonjësve të sistemit arsimor parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët, si dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), të institucioneve arsimore parauniversitare publike që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në largësinë mbi 5 km deri në 50 km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, si dhe mbulimin e shpenzimeve të transportit për kategoritë përfitues të cituar më lart.

Ndryshimi i propozuar nëpërmjet këtij projektvendimi, ka lindur si nevojë për të saktësuar disa problematika të cilat janë evidentuar gjatë zbatimit të vendimit në fuqi, si dhe për të garantuar shërbimin e transportit për nxënësit dhe punonjësit e

sistemit arsimor parauniversitar, shërbim i cili aktualisht, për shkak të vlerës së ulët të biletës, në shumicën e rasteve nuk arrin të sigurohet nga operatorët ekonomikë ofrues të shërbimit të transportit. Për këtë qëllim, në projektvendim është parashikuar të shtohet edhe një bonus prej 50% mbi çmimin e indeksuar të biletës, për nxënësit. Gjithashtu, në projektvendim janë parashikuar afate të përcaktuara për të realizuar procedurën e prokurimit publik të këtij shërbimi, si dhe mënyrën dhe institucionet përgjegjëse, të cilat do të realizojnë këto procedura.

Referuar vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, institucionet përgjegjëse për realizimin e procedurave të prokurimit publik janë përcaktuar drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, të cilat kanë strukturat e nevojshme të burimeve njerëzore për të realizuar procedurat e prokurimit. Fondet për këtë shërbim detajohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, për llogari të zyrave vendore të arsimit parauniversitar, të cilat në varësi me kontratën e nënshkruar dhe shërbimin e realizuar kryejnë procedurat e pagesës për llogari të kontraktorit të shërbimit ose në rast se procedura dështon, sipas parashikimeve në projektvendim, zyra vendore e arsimit parauniversitar, realizon pagesën përmes transferimit nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, kujdestarëve ligjorë apo përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve të arsimit parauniversitar publik përfitues. Kjo procedurë është parashikuar më qëllim që në çdo rast, nxënësit dhe punonjësit e arsimit parauniversitar publik të kenë mundësi të sigurojnë transport përgjatë gjithë periudhës së vitit mësimor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË DHE EFEKTET E PRITSHME

Në përgatitjen e këtij projektvendimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka marrë parasysh parashikimet e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe janë mbajtur parasysh edhe kërkesat e ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, të ligjit nr.

9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 137/2020, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar.

Projektvendimi përcakton qartë mënyrën e përlllogaritjes së masës së shpenzimeve për nxënësit, duke përcaktuar se kjo shumë përlllogaritet duke u bazuar në numrin e ditëve mësimore, numrin e nxënësve që kanë ndjekur mësimin, çmimit të indeksuar me normën e inflacionit të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetëse të shërbimit të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, duke shtuar edhe një bonus për ta prej 50% mbi çmimin e indeksuar të biletës, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Përmes këtyre ndryshimeve, ministria përgjegjëse për arsimin ka për qëllim të garantojë shërbim transporti cilësor të nxënësve dhe të punonjësve të arsimit parauniversitar publik përfitues, dhe veçanërisht në zonat ku aktualisht shfaqen problematika për shkak të vështirësive të linjave të transportit dhe të çmimit të ulët, i cili aktualisht nuk ofron interes për operatorët ekonomikë të këtij shërbimi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave propozohet bazuar në nenin 100 të Kushtetutës, nenet 5, 6, 19 dhe 28 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreun II të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportin rrugor", i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet më çështjet e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që numoinë dhe të nxënësve që mësojnë iashtë vendbanimit”. i ndryshuar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendimi ka si qëllim parashikimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar, duke parashikuar mënyrën e përlllogaritjes së masës së shpenzimeve për nxënësit, duke synuar në këtë mënyrë parashikimin e një procedurë të qartë të llogaritjes së kësaj mase shpenzimesh. Shtesat dhe ndryshimet konsistojnë si vijon:

Germa “a” e pikës 1, të projektvendimit parashikon shtimin e fjalëve në shkronjën “a”, të pikës 1, të vendimit në fuqi duke zgjeruar rrethin e subjekteve përfitues, duke përfshirë oficerët e sigurisë, punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe pas fjalëve “mbi 5 km” do të shtohen fjalët “... deri në 50 km ...”.

Germa “b” e pikës 1, të projektvendimit parashikon që pika 2, e vendimit në fuqi të ndryshohet duke përcaktuar se njësitë e vetëqeverisjes vendore, miratojnë rrjetin e linjave të transportit, mbështetur në numrin e fëmijëve, nxënësve dhe të mësuesve që planifikohen të përfitojnë nga ky shërbim, sipas kriterëve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, bazuar në informacionin që marrin nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar, brenda muajit tetor për vitin e ardhshëm buxhetor. Listat e përfituesve, konfirmohen nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar pranë njërive të vetëqeverisjes vendore për distancën nga vendbanimi i përhershëm dhe dërgohen në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar për të realizuar procedurën e prokurimit publik brenda muajit nëntor për vitin e ardhshëm buxhetor.

Germa “c” e pikës 1, të projektvendimit parashikon që pika 3, e vendimit në fuqi të ndryshohet duke përcaktuar se Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar prokurojnë fondet publike për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë sipas rrjetit të linjave të transportit rrethqytetase, të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose qendrore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Me fillimin e procedurës së prokurimit publik, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar autorizojnë zyrat vendore të arsimit parauniversitar të mbulojnë shpenzimet për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë përfitues deri në përfundim të procedurave të prokurimit dhe lidhjes së kontratës, me fondet e akorduara nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin për këtë qëllim.

Germa "d" e pikës 1, të projektvendimit parashikon që pika 4, e vendimit në fuqi të ndryshohet duke përcaktuar se Në rastet kur procedura e prokurimit publik të linjave të transportit, të parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi, nuk realizohet me sukses nga drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar, me autorizimin e kësaj të fundit, zyra vendore e arsimit parauniversitar siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve të arsimit parauniversitar publik përfitues, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve kujdestarëve ligjorë apo përfituesve me prokurë të posaçme ose nëpërmjet shërbimit postar për ato zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi, deri në përfundim të vitit buxhetor.

Masa e shpenzimeve për llogaritjet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të mësuesve që janë paraqitur në punë, numrit të nxënësve që kanë ndjekur mësimin, çmimit e indeksuar me normën e inflacionit të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetëse të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", të ndryshuar, duke shtuar vetëm për nxënësit, edhe një bonus prej 50% mbi çmimin e indeksuar të biletës, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke filluar nga data 01.01.2022 dhe në vijim.

Germa "e" e pikës 1, të projektvendimit parashikon që në fund të fjalisë së shkronjës "c" të pikës 5, të vendimit në fuqi, të shtohet togfjalëshi "deri në 50 km".

Germa "f" e pikës 1, të projektvendimit parashikon që pika 5/1, e vendimit në fuqi të ndryshohet duke parashikuar se Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe koordinojnë të dhënat për numrin e përfituesve dhe largësitë nga vendbanimi dhe raportojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin, çdo tre muaj.

Germa "g" e pikës 1, të projektvendimit parashikon që pika 6, e vendimit në fuqi të ndryshohet duke parashikuar se efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti i përvitshëm i ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila transferon fondet përkatëse te zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rastet kur me vendim të organeve kolegjiale, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të financojnë shpenzime transporti për nxënësit dhe punonjësit e arsimit parauniversitar publik edhe për distanca të tjera, jashtë parashikimeve të këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin, ministria përgjegjëse për financat, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe njësitë e vetëqeverisje.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Për hartimin e këtij projekt-vendimi ka kontribuar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektvendimi sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit për vitin 2022, në shumën 300.000.000 (treqind milion) lekë. Efektet shtesë që rrjedhin nga ky projektvendim, lidhur me bonusin prej 50% mbi çmimin e indeksuar të biletës, janë parashikuar të hyjnë në fuqi nga data 1 janar 2022 dhe do të përballohen nga buxheti i vitit 2022.

PROPOZUESI

MINISTËR

EVIS KUSHI